



## Buletini informativ # 6 – tetor-dhjetor 2013

---

- Seanca e 18-të e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Shkelja e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë sa i përket të drejtës për zgjidhje efektive
- Takimi me shefin e misionit të EULEX-it
- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në kontekstin ndërkombëtar
- Fushata informuese

### Seanca e 18-të

Seanca e 18-të e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) është mbajtur në Prishtinë nga data 25 - 27 nëntor 2013. Paneli ka shqyrtuar nëntë ankesa dhe ka marrë vendime lidhur me katër lëndë. Në fillim të seancën kanë qenë 30 ankesa të papërfunduara pranë Panelit.

---

### Zbatimi i rekomandimeve të Panelit nga shefi i Misionit

Në një vendim pasues në lëndën [W kundër EULEX-it](#) Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it ka zbatuar rekomandimet e Panelit vetëm pjesërisht. Kjo lëndë ka të bëjë me prokurorët e EULEX-it, të cilët kanë dërguar dëshminë dhe informacione të tjera personale të ankuesit tek autoritetet shtetërore në Serbi për një hetim të krimeve të luftës. Paneli ka deklaruar se ka pasur arsyetim të pamjaftueshëm për zbulimin e kësaj deklarate dhe të dhënave personale të ankuesit për shkak të mungesës së bazës ligjore, pa pëlqimin e tij dhe pa kryerjen e vlerësimit të rrezikut për të përcaktuar masat mbrojtëse të nevojshme për t'i kufizuar rreziqet potenciale.

Ndërsa disa prej rekomandimeve të Panelit janë zbatuar, është vërejtur se nuk është zbatuar rekomandimi që prokurorët e EULEX-it duhet të kërkojë prej homologëve të tyre serbë t'i kthejnë apo t'i asgjësojnë kopjet e dokumenteve, të cilat mbajnë emrin e ankuesit dhe të fshijnë çfarëdo informacioni në dokumentet e tjera që mund ta identifikojnë atë. Për më tepër, nuk është kryer vlerësimi i rrezikut, që është rekomanduar nga Paneli. Paneli rrjedhimisht ka ftuar shefin e Misionit të rishikojë zbatimin e rekomandimeve të tij.

### Vendimet e papranueshmërisë

Paneli ka shpallur tre lëndë të papranueshme. [Një lëndë](#) ka të bëjë me akuzat për korrupsion ndaj kryetarit të komunës së Kllokotit. Përderisa Paneli nuk ka përjashtuar se në rrethana të veçanta

sjellja korruptive e një zyrtari publik mund t'i japë statusin e viktimës një individi, të drejtat e njeriut e të cilin janë prekur nga një sjellje e tillë, Paneli ka konstatuar se ankuesi nuk ka treguar të ketë vuajtur ndonjë pasojë të drejtpërdrejtë të dëmshme nga veprimi për të cilin është ankuar.

Një lëndë tjetër është shpallur e papranueshme pasi ajo kishte të bënte me dështimin e supozuar të nxjerrjes së një ligji nga autoritetet e Kosovës, duke qenë një çështje që nuk kishte të bënte me mandatin ekzekutiv të EULEX-it. Në një lëndë tjetër që kishte të bënte me kompensimin e punës së detyruar, Paneli ka konstatuar se ajo ankesë është e pabazuar pasi EULEX-i nuk ishte përfshirë në asnjë rrethanë në atë çështje.

---

### Takimi me shefin e Misionit të EULEX-it, Bernd Borchardt

Më 26 nëntor 2013, Paneli është takuar me shefin e Misionit të EULEX-it, Bernd Borchardt. Diskutimi ishte përqendruar në restrukturimin e Misionit dhe ndikimin e tij të mundshëm në mandatin ekzekutiv. Tema tjera

të diskutimit kanë qenë fushata e vazhdueshme informuese e Panelit, si dhe çështjet e bashkëpunimit teknik në mes të dy institucioneve.



Nga e majta në të djathtë: shefi i misionit Bernd Borchardt, Tanja Tamminen, këshilltare për politikë/zyrtare raportuese, anëtar i Panelit Guénaél Mettraux dhe kryesuesja e Panelit Magda Mierzewska


PShDNj-ja ka përpunuar një tabelë të jurisprudencës, duke theksuar shumë çështje që lidhen me juridiksionin e vet, çështjet procedurale si dhe lidhur me meritat e ankesave. Tabelën mund ta shihni përmes faqes së internetit të Panelin në <http://www.hrrp.eu/jurisprudence.php>

### Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në kontekstin ndërkombëtar

Rëndësia e Panelit është vënë në pah së fundi nga Këshilli i Evropës në një projekt-rezolutë rreth "Llogaridhënies së organizatave ndërkombëtare ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut", duke përshkruar Panelin si model që mund të përdoret në situata të ardhshme kur organizatat ndërkombëtare marrin ndonjë

rol administrativ. Paneli ka gjetur një reflektim tjetër në një artikull nga prof. Georg Nolte, Universiteti i Humboldt-it, Berlin. Gjithashtu, Paneli për herë të parë është përmendur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në vendimin e tij Azemi kundër Serbisë.

## Statistika e lëndëve - Dhjetor 2013



### Fushata informuese

Më 26 nëntor 2013, Paneli ka marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët me Projektin "Mbështetje e mëtejshme për Zbatimin e Strategjive për PZHBV-të, refugjatë dhe të kthyer - ndihmë juridike" në Graçanicë. Projekti është financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Serbi.

Paneli ka paraqitur parimet bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për gjykim të drejtë) dhe ka

diskutuar me pjesëmarrësit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Tema të tjera të diskutimit kanë qenë mandati dhe jurisprudenca e Panelit.

Aktivitete të tjera gjatë fushatës informuese gjatë muajit tetor dhe nëntor 2013 kanë qenë takimet me OJQ, organizata ndërkombëtare dhe anëtarë të gjyqësorit në Prishtinë, Shtërpcë dhe Gjilan.



Anëtarët e Panelit: Guénaél Mettraux, Katja Dominik dhe kryesuesja e Panelit Magda Mierzevska me udhëheqësin e ekipit Massimo Moratti dhe stafin e projektit "Mbështetje e mëtejshme për zbatimin e strategjive për PZHBV-të, refugjatë dhe të kthyer - Ndihmë juridike".

## PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

### Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

### Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

### Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

### Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

### Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

#### Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)

### Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.